



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2019:207565

Datë: 28.09.2021

Numri i dokumentit: 02219374

C.nr.42/11

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, DEGA NË MALISHEVË, Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Civil, Gjyqtari Nehat Qelaj si dhe me Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina, në çështjen juridike të paditëses, K. E. e K. Sh.A D. i F., D. Gj., kundër të paditurit, M. K. nga fshati T., Komuna e Malishevës, lidhur me kompensimin e borxhit, pas mbajtjes së seancës kryesore, me datë 28.09.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. MIRATOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit K. E. e K. Sh.A D. i F., D.Gj..
- II. DETYROHET** i padituri M. K. nga fshati T., Komuna e M., që paditëses në emër të borxhit për konsumim të energjisë elektrike t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 1,968.57 € të përlllogaritur për periudhën nga data 06.10.2009 deri me datën 04.10.2010, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 3.5 % nga dita e përpilimit të këtij Aktgjykimi datë 28.09.2021, e në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmarimit të detyruar.
- III. DETYROHET** i padituri që t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në emër të taksës gjyqësore në shumën prej 50.00 euro.
- IV. REFUZHET** pjesërisht si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditëses për shkak të parashkrimit në shumën prej 6,170.10 euro e përlllogaritur gjerë me datë 27.09.2009.

A r s y e t i m

Paditësi K. E. e K. Sh.A D. i F., D.Gj., në këtë gjykatë me dt.03.11.2010 ka parashtruar propozim për ekzekutim, në bazë të dokumentit autentik, faturës Nr.... të dt. 04.10.2010 kundër të paditurit M. O. K. nga fshati T., Komuna e Malishevës për konsumin e energjisë elektrike deri me dtë 30.09.2010 në vlerën prej 7,827.48 €.

Gjykata Komunale në Malishevë me dt.31.02.2011 kishte nxjerr aktvendimin me E.nr.507/2010, me të cilën e ka caktuar ekzekutimin e propozuar në shumën prej 7,827.48 euro.

I Padituri me dt.08.02.2011 në këtë gjykatë në afatin ligjor ka parashtruar kundërshtimin me të cilin e ka goditur aktvendimin e lejuar E.nr.507/2010 të dt.31.02.2011 për përmbarimin e propozuar, sipas propozimit të kreditorit-Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.-Divizioni i furnizimit, e që sipas ligjit të LPP-së në atë kohë në fuqi me paraqitjen e këtij kundërshtimi, propozimi i Kreditores menjëherë është shndërruar në padi.

Pas parashtrimit të kundërshtimit nga ana debitorit çështja mes palëve ndërgjyqëse është trajtuar si çështja kontestimore me objekt të padisë pagimin e borgjit.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditëses e ka njoftuar të paditurin me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

I padituri përmes përgjigjes së tij në padi të parashtruar me datë 06.12.2013, ndër të tjera ka theksuar duke e kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, gjithashtu ka theksuar se kemi të bëjmë me fatura të viteve të kaluara, por ndoshta edhe me ndonjë kompensim të dëmit i cili nuk është i bazuar me asnjë provë, prandaj përpos të dhënave të sipërshënuara këtu vije në shprehje edhe parashkrimi i kërkesëpadisë, fakt që do të vërtetohet gjatë seancave gjyqësore, duke i propozuar gjykatës që pas shqyrtimit të të gjitha provave t'a refuzoi kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar.

I autorizuari i paditëses në shqyrtimin kryesor ka deklaruar duke mbetur pranë propozimit për ekzekutim të datës 03.11.2010 lidhur me dëmin e shkaktuar nga pala e paditur ku është konstatuar se është shfrytëzuar energjia elektrike në mënyrë kundërligjore, provë faktura e lëshuar numër ... në të cilën konstatohet se i njëjti ka shkaktuar dëmin në vlerë prej 7,827.48 euro, ndërsa sa i përket parashtrësës së datës 31.03.2015 në të cilën i padituri është thirrur në parashkrim, konsiderojmë se gjykata fare të mos e administroj, pasi që e njëjta nuk është e mbështetur në dispozitat e LMD-së, me të cilat është thirrur, në seancën e datës 05.07.2021 i autorizuari i paditëses ka dorëzuar parashtrësën mbi transaksionin e debitorit, po ashtu edhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar duke mbetur pranë propozimit për ekzekutim si dhe deklaratave të cekura më herët, me të cilat konsiderojmë se gjykatës i kemi ofruar dëshmi të mjaftueshme se kemi të bëjmë me një kërkesë të bazuar, gjykatës i ka propozuar që të njëjtën t'a aprovon në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë në emër të taksës gjyqësore në shumën prej 50 euro.

I padituri në seancën e shqyrtimit përgatitor të datës 06.02.2015 ka theksuar duke mbetur pranë përgjigjes në padi të parashtruar me datë 06.12.2013, nga gjykata kërkoj që t'a refuzoj kërkesëpadinë e paditësit për arsye të shumës së lartë të faturuar për kinse unë e kamë hargjuar energjinë elektrike, ndërsa në seancat e shqyrtimit kryesorë i padituri nuk ka prezantuar edhe pse i njëjti konstatohet se është ftuar në mënyrë të rregulltë nga gjykata, ndërsa përmes parashtrësës së datës 31.03.2015 të dorëzuar pranë kësaj gjykate i padituri ka deklaruar duke e kundërshtuar në tersi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, po ashtu ka theksuar se kërkesëpadia e paditëses është e parashkruar dhe nuk ka asnjë bazë ligjore për të kërkuar shumën e borxhit e cila është e precizuar në kërkesëpadi, meqenëse padinë pala paditëse e ka paraqitur në fillim të vitit 2011, kurse borxhi për të cilën ka bërë padi pala paditëse ka të bëjë para këtij viti, deri në fillim vitit 2010 borxhi ndaj paditëses është i parashkruar.

Me qellim të vërtetimit të drejt dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave bëri administrimin e provave relevante materiale me

leximin e tyre dhe ate : transaksionin e konsumatorit i dt.25.05.2021 DGJ-.... fakturën numër DGJ-.... e datës 04.10.2010, procesverbalin e kësaj gjykate nr. E.nr. 507/10 të datës 07.02.2010, parashtrësën e të paditurit të datës 30.03.2015 dhe kundërshtimin e debitorit – të paditurit të datës 08.02.2011.

Gjykata pasi vlerësoj provat e administruar e në kuptim të nenit 8 te LPK-se gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Nga aktvendimi mbi lejjimin e ekzekutimit E nr. 507/2010 datë 31.02.2011, u vërtetua se mbi bazën e faturës numër së datës 04.10.2010, Gjykata Komunale në Malishevë ka lejuar ekzekutimin për pagesën e borgjit.

Nga kundërshtimi i paditurit u vërtetua se i njëjti ka kontestuar borxhin që ka ndaj paditëses, ndërsa nga pasqyrat e transaksionit të konsumatorit DGJ-.... u vërtetua gjendja apo bilanci për të paditurin ndaj paditëses në shumë prej 12.952.80 euro.

Nga shqyrtimi i provave të lartpërmendura, në veçanti duke u bazuar në pasqyrën transaksionit të konsumatorit DGJ-.... shihet se me datë 27.09.2009 nga paditësja të paditurit i është bartur borxhi në emër të energjisë së shpenzuar elektrike në vlerë prej 6,17.10 euro ndërsa nga kjo datë e deri me datë 04.10.2010 borxhi për konsumim energjisë elektrike ka arritur në shumë prej 7,827.48 euro mirëpo meqenëse i padituri është thirru në parashkrim të borxhit gjykata vërtetoi se i padituri ka borxh paditëses shumë prej 3.901.36 euro që duhet kompensuar për periudhën nga data 27.09.2009 e deri 04.10.2010, ndërsa pjesa tjetër e borxhit në shumën prej 6,170.10 euro për periudhën deri me datë 27.09.2009 është borxh i parashkruar andaj dhe gjykata vendosi për të aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses dhe të detyroj të paditurin që të paguaj borxhin, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Bazuar në këtë gjendje faktike gjykata vlerëson se i padituri për shkak të mos pagesës borxhit për shërbimin – konsumimin e energjisë elektrike, ka hyrë në raport detyrimeve me paditësin, në të cilin raport paditësi e ka cilësinë e kreditorit, kurse i paditurit e ka cilësinë e debitorit.

Gjykata, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve të të paditurit lidhur me parashkrimin e borxhit, gjeti se prapësimi i të paditurit është pjesërisht i bazuar, për faktin se borxhi i ngarkuar për të paditurin për periudhën kohore gjerë me datë 27.09.2009 që përfshinë shumë prej 6,170.10 euro është borxh i parashkruar, ngase paditësja propozimin për përmbarim e ka paraqitur më datë 03.11.2010, që rezulton se deri më këtë datë është parashkruar borxhi për këtë shumë, bazuar në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Gazeta Zyrtare e R.. Nr. 40/53 dhe) ligj i cili ishte në fuqi në kohën e krijimit të marrëdhënies juridike në nenin 378 parashihet citoj lidhur me parashkrimin e kërkesave përcaktohet se ***“Parashkruhen për një vjet kërkesa e kompensimit për livrimin e energjisë elektrike e të ngrohjes, gazit, ujit dhe shërbimet e spastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e pastërtisë, kur livrimi, respektivisht shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake, Kërkesa e radiostacionit dhe kërkesa e radiotelevizionit për përdorimin e aparatit të radios dhe të aparatit televiziv, Kërkesat e postës, telegrafit e të telefonave për përdorimin e telefonit e të separateve postare, si dhe kërkesat e tjera të tyre që arkëtohen në afatet tremujore, apo më të shkurtëra, Kërkesat e parapagimit në botimin periodik, duke llogaritur nga skadimi i kohës për të cilin është porositur botimi, Parashikimi rrjedh gjithëse livrimet apo shërbimet janë zgjatur”***, ndërsa si borxh valid të cilën detyrohet t’u paguaj i padituri është shuma prej 1,968.57 euro e përlllogaritur për çdo muaj nga data e paraqitjes së propozimit për përmbarim, dhe se nga kjo datë konsiderohet se me paraqitjen e

propozimit nga ana e paditëses i njëjti e ka ndalur parashkrimin e borxhit, lidhur me ndërprerjen e parashkrimit në dispozitat e LMD –së neni 387 përcaktohet se **“Parashkrimi ndërpritet kur debitori pohon borxhin, Pohimi i borxhit mund të blihet jo vetëm duke i dhënë deklaratë kreditorit por edhe në mënyrë indirekte, siç janë dhënia e kisteve, pagimi i kamatave, dhënia e sigurimit.”**, dhe mbi këtë baze, gjykata gjen se detyrimi i të paditurit rrjedhë në bazë të nenit 17 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 në të cilin theksohet citoj **“Pjesëmarrësit e marrëdhënies së detyrimit kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij, përgjegjës për përmbushjen e tij”**, po ashtu në nenin 262 të të njëjtit ligj parashihet citoj **“Kreditori në raportin e obliguar është autorizuar që prej debitorit të kërkojë mbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta mbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”**.

Vendimi për shpenzime procedurale është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së dhe atë për taksën gjyqësore shumë prej 50 euro.

Nga sa u tha, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi komforë nenit 143 të LPK-së.

**Gjykata Themelore në Gjakovë- Dega në Malishevë
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.42 /11 e datës 28.09.2021**

**G J Y Q T A R I
Nehat Qelaj**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit e Kosovës në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme.